



R E P U B L I K A E S H Q I P È R I S È

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEPARTAMENTI TEKNIK I AKCIZËS DHE PROCEDURAVE DOGANORE

Nr. 7921 Prot.

Tiranë, më 28/03/2019

UDHËZIM

Nr. 05, datë 28.3.2019

PËR

ZBATIMIN PRAKTIK TË PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN DHE FUNKSIONIMIN  
E PËRFAQËSIMIT NË DOGANË

Në zbatim të neneve 24 – 26 të Ligjit nr. 102/2014, date 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar; neneve 78 - 88 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 651, datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë";

Me qëllim përcaktimin dhe zbatimin praktik të procedurave për miratimin dhe funksionimin e përfaqësimit në doganë;

Në mbështetje të pikës 1(b)(i), të Pjesës VIII/I, të VKM Nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për personelin e Administratës Doganore", të ndryshuar, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave,

U D H Ë Z O N:

I. Të përgjithshme

- Legislacioni doganor lejon që çdo person të përfaqësohet në doganë me qëllim përbushjen e formaliteteve të caktuara doganore. Ky njihet si "përfaqësim".
- "Përfaqësues doganor" është çdo person i caktuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, nga një person tjetër, për të kryer veprimet dhe formalitetet e kërkua nga legjislacioni doganor në marrëdhëniet e tij me autoritetet doganore.
- Parashikohen dy forma të përfaqësimit në doganë: përfaqësim i drejtpërdrejtë dhe përfaqësim i tërthortë.
- Në rastin e *përfaqësimit të drejtpërdrejtë (direkt)*, përfaqësuesi vepron në emër dhe per llogari të palës së interesuar (personit/operatorit). Në këtë rast pala e interesuar (personi/operatori) është deklaruesi.

5. Në rastin e *përfaqësimit të tërthortë*, përfaqësuesi doganor kryen veprimet dhe formalitetet doganore në emër të tij, por për llogari të palës së interesuar. Në këtë rast deklarues është përfaqësuesi i tërthortë.
6. Në të dyja rastet si në përfaqësimin e drejtpërdrejtë edhe atë të tërthortë, përfaqësuesi doganor duhet të liçencohej nga DPD për të vepruar si i tillë.
7. "I përfaqësuar", do të konsiderohet pala e interesuar për tu përfaqësuar në doganë, që është çdo person (fizik ose juridik) në emër e për llogari të të cilit kërkohet të kryhen formalitetet doganore në përputhje me legjislacionin doganor në fuqi.
8. Të gjithë përfaqësuesit, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë duhet të njojin dhe përbushin me korrekësi detyrimet që rrjedhin nga ushtrimi i aktivitetit si përfaqësues doganor.
9. Përfaqësuesit doganor kanë pergjegjesi për plotësimin, saktësinë dhe tërësinë e informacionit të dhënë në deklaratë, në njoftim ose aplikim.
10. Të gjitha dokumentet e nënshkruara nga një agjent doganor duhet të vulosen me vulën e tij personale. Kjo vulë duhet të ketë emrin e agjentit, emrin e agjencisë dhe numrin identifikues të tij. Nënshkrimi dhe/ose vulosja mund të bëhet edhe në rrugë elektronike, sipas legjislacionit në fuqi.

## II. Prova e përfaqësimit

1. Për kryerjen e formaliteteve doganore, përfaqësuesi duhet të jetë i autorizuar nga i përfaqësuari për çdo operacion.
2. Për të provuar që përfaqësuesi doganor po vepron për llogari të të përfaqësuarit shërben "prova e përfaqësimit".
3. "Prova e përfaqësimit" është akti ligjor (autorizim/prokurë) i nënshkruar nga të dyja palët (i përfaqësuari dhe përfaqësuesi) në të cilën janë përcaktuar të paktën detaje si, emrat e palëve, NUIS/NIPT, tagrat e përfaqësimit, vlefshmëria e autorizimit/prokurës, etj.
4. Si provë e përfaqësimit përdoret/njihet "prokura notierale". Megjithatë nuk përjashtohet përdorimi i modelit "autorizim" në rastin e deklarimeve rastësore.
5. Prova e përfaqësimit nuk i kërkohet përfaqësuesit doganor për çdo operacion, nëse ai vepron rregullisht si përfaqësues dhe disponon një provë përfaqësimi (prokurën) të vlefshme, që mund tu vihet në dispozicion autoriteteve doganore sa herë që kërkohet nga këto të fundit.

## III. Regjistri i përfaqësuesve doganorë

Drejtoria e Procedurave Doganore në DPD i regjistron të gjithë përfaqësuesit doganor, qofshin këta të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në një regjister elektronik. Regjistri elektronik përmban për çdo përfaqësues të dhënat lidhur me: numrin e autorizimit/licencës së përfaqësuesit/agjentit, shoqërinë apo agjencinë doganore për të cilën punon, kodin personal të përfaqësimit, zyrën/zyrat doganore ku vepron.

#### **IV. Njoftimi për ndryshimin e informacionit të dhënë autoriteteve doganore**

1.Të gjithë përfaqësuesit doganorë janë të detyruar që për çdo ndryshim që do të kenë gjatë veprimtarisë së tyre të përfaqësimit të njoftojnë menjëherë me shkrim Drejtorinë e Procedurave Doganore pranë DPD.

Me ndryshim do të kuptohet çdo element i informacionit që disponohet prej DPD për përfaqësuesin në fjalë apo çdo faktor tjetër që ndikon në vazhdimësinë e përfaqësimit (detaje mbi statusin, adresën, përfaqësuesit apo agjentët...).

#### **V. Procedurat që zbatohen për miratimin e përfaqësuesve të drejtpërdrejtë**

1. Kushtet e përcaktuara që duhet të plotësojë personi (individ) për të vepruar si përfaqësues i drejtpërdrejtë janë si më poshtë:

- a) të ketë shtetësi shqiptare;
- b) të ketë diplomë universitare;
- c) gjyket i besueshëm nga administrata doganore;
- ç) të mos ketë kryer shkeljet e parashikuara sipas pikës 5, të nenit 78, të VKM nr.651, datë 10.11.2017;
- d) të zotërojë një marrëveshje kontraktuale;
- dh) prokurë përfaqësimi;
- e) personi (individ) nuk duhet të jetë i punësuar në administratë publike apo shtetërore.

I përfaqësuari dhe përfaqësuesi nuk duhet të rezultojnë debitorë ndaj administratës doganore dhe asaj tatimore.

2. Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të depozitohet për personin/individin është si më poshtë:

- a) kopje e kartës së identitetit/pasaportës (për të provuar që është person i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë me përjashtim të rasteve që parashikohen në nenin 155 pika 3 të Ligjit 102/2014 - Kodi Doganor);
- b) kopje te njehsuar të diplomës universitare;
- c) vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe nga Organi i Prokurorisë, si dhe vërtetim të gjëndjes gjyqësore (dëshmi penaliteti);
- ç) marrëveshje kontraktuale punësimi me të përfaqësuarin;
- d) prokurë përfaqësimi të nënshkruar përpala një noteri;
- dh) vërtetim që personi nuk është i punësuar në administratën publike apo shtetërore.

Nëse disponohet paraqiten edhe çertifikata apo diploma që dëshmojnë njohuritë/experiencën në fushën fiskale.

3. *Modeli i kërkesës për miratim të përfaqësuesit të drejtpërdrejtë paraqitet në Aneksin 1 bashkëngjitur, i cili do të plotësohet, nënshkruhet dhe autentifikohet nga pala që kërkon të përfaqësohet.*

4. Kërkesës i bashkëngjitet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm që vërteton plotësimin e kushteve dhe paraqitet pranë DPD-së.

5. Përfaqësuesi nënshkruan personalisht në kutinë përkatëse të kërkesës në prezencë të punonjësit të ngarkuar me shqyrtimin e saj, duke bërë të mundur depozitim e firmës për njohje dhe krahasimin e saj me nënshkrimin në dokumentin e identifikimit.

6. Drejtoria e Procedurave Doganore në DPD pasi shqyrton përbushjen e kushteve dhe dokumentacionin, përgatit për miratim *autorizimin*, sipas modelit të Aneksit nr. 2, bashkëngjitur.

7. Çdo autorizim përmban një numër rendor që përbëhet nga 3 (tre) shifra dhe shkronjën "D" në fund.

8. Pas miratimit të autorizimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Drejtoria e Procedurave Doganore kryen veprimet e regjistrimit në sistemin ASYCUDA World.

9. Çdo i përfaqësuar për nevoja të deklarimit në doganë do të identifikohet me një kod individual të përdoruesit në sistem, (p.sh. kodi D- - -).

10. Në rastet kur i përfaqësuari, vendos të mos përfaqësohet më nga përfaqësuesi për të cilin DPD-ja ka lëshuar një autorizim njofton menjëherë me shkrim Drejtore e Procedurave Doganore për ndërprerjen e kontratës së punës dhe që prokura e lëshuar nuk është më në fuqi.

11. Pas marrjes së njoftimit, Drejtoria e Procedurave Doganore kryen ndryshimet e duhura në regjistrin elektronik të përfaqësuesve të drejtpërdrejtë dhe mbyll në sistem të drejtat e përfaqësuesit në fjalë.

## **VI. Procedurat për miratimin e përfaqësimit të tërthortë**

1. Kushtet që duhet të plotësojë personi (individu) për të vepruar si përfaqësues i tërthortë "agjent doganor" janë si më poshtë:

- a) të ketë shtetësi shqiptare;
- b) të ketë diplomë universitare;
- c) të gjykohet i besueshëm nga administrata doganore;
- ç) të mos ketë kryer shkeljet e parashikuara sipas pikës 5, të nenit 78, të VKM nr.651, datë 10.11.2017;
- d) të kalojë provimin e parashikuar në nenin 82, të VKM nr.651, datë 10.11.2017;
- dh) të ketë eksperiencë pune si punonjës pranë një agjencie doganore jo më pak se 1 vit;
- e) nuk duhet të jetë i punësuar në administratën publike apo shtetërore.

2. Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të depozitohet është si më poshtë:

- a) kopje e kartës së identitetit/pasaportës (për të provuar që është person i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë me përjashtim të rasteve që parashikohen në pikën 3, të nenit 155 të Kodit Doganor);
- b) kopje të njehsuar të diplomës universitare;
- c) vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Organi i Prokurorisë, si dhe vërtetim të gjëndjes gjyqësore (dëshmi penaliteti);
- ç) certifikata apo diploma që dëshmojnë njohuritë e duhura apo experiencë në fushën fiskale, nëse ka;
- d) rezulton kalues në testimin/provimin e zhvilluar për këtë qëllim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

dh) dokument mbi eksperiencën e punës si punonjës ndihmës pranë një agjencie doganore jo më pak se 1vit;

e) vërtetim/deklarim që personi nuk është i punësuar në administratën publike apo shtetërore.

3. Të gjitha dokumentat e mësipërme së bashku me kërkesën e kandidatit për agjent doganor duhet të depozitoohen pranë DPD-së.

4. Liçenca për të vepruar si agjent doganor lëshohet pa afat dhe miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, sipas *Modelit të Aneksit Nr. 3*, bashkëngjitur.

Aktivizimi i userit të agjentit të licencuar në sistem, do të kryhet pas paraqitjes së një kërkesë me shkrim nga agjencia doganore për llogari të së cilës do të punojë.

Agjentit do ti caktohet një numër identifikimi individual (në varësi të kodit të agjencisë) dhe do ti hapet user për të vepruar në sistem.

5. DPD nuk licenson personat që:

- a) kanë kryer shkelje të qëllimshme, sipas përcaktimeve në nenin 253 të Kodit Doganor;
- b) kanë kryer shkelje të përsëritura të legjisacionit doganor, të akcizës ose atij tatimor;
- c) janë përfshirë në ndonjë aktivitet të paligjshëm, ose që janë dënuar për vepra penale.

Po kështu, nuk kanë të drejtë të rimarrin licencë ata persona që ju është revokuar liçenca e lëshuar para datës 1 qershori 2017.

6. Të gjithë personave (individëve) që ju është miratuar leja e ushtrimit të aktivitetit si “agjent doganor” nga DPD mund të ushtrojnë veprimtarinë, për të cilën janë licencuar *vetëm nëpërmjet një agjencie doganore që është person juridik*.

7. Kushtet që duhet të përbushë personi juridik për tu licencuar si “agjenci doganore” janë:

- gjykohet i besueshëm nga administrata doganore;
- paraqet një kopje të vendimit për regjistrimin e tij si person juridik;
- depoziton një garanci në shumën 50.000.000 (pesëdhjetë milionë) lekë, në përputhje me nenet 84 deri 93, të Kodit Doganor.

8. Dokumentacioni i nevojshëm për liçencim është si më poshtë:

- a) dokumenti i regjistrimit si person juridik pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit (ku përshkruhet qartësisht objekti i aktivitetit si agjensi doganore), si dhe kopje të NUIS (Numri Unik Identifikues i Subjektit);
- b) vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, nga Organi i Prokurorisë për shoqërinë, si dhe vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, nga Organi i Prokurorisë dhe vërtetim i gjëndjes gjyqësore (dëshmia e penalitetit) për administratorin (përfaqësuesin ligjor) apo ortakët e shoqërisë (në varësi të rastit);
- c) kopje origjinale e garancisë në shumën 50.000.000 (pesëdhjetë milionë) lekë për llogari të DPD-së, në përputhje me nenet 84 deri 93 të Kodit Doganor.

Personi juridik nuk duhet të rezultojë debitor ndaj administratës doganore apo tatimore.

9. Pas shqyrtimit dhe plotësimit të kushteve, Drejtoria e Procedurave Doganore përgatit liçencën, e cila miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, sipas *Modelit të Aneksit nr. 4*, bashkëngjitur.

10. Çdo licencë e lëshuar për ushtrimin e aktivitetit të agjencisë doganore do të përbajë kodin përkatesë të identifikimit që fillon me shkronjën “J...”, kod i cili do të regjistrohet edhe në sistemin ASYCUDA World.

## VII. Procedurat e konkurimit për agjentë doganor.

1. Provimi për agjent doganor organizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Në varësi të kërkesave një muaj përpëra konkurimit kryet njoftimi i datës së përshtashme për provim e cila publikohet në faqen web të doganës dhe në shtypin e shkruar.

2. Pas njoftimit Drejtori i Përgjithshëm i Doganave me anë të një urdhëri përcakton përbërjen e Komisionit.

3. Komisioni kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave dhe ka në përbërje të tij Drejtorin e Procedurave Doganore ose përgjegjësin e një prej sektorëve në këtë Drejtori, dhe dy kryetarë Degësh Doganore.

4. Komisioni do të shqyrtojë kërkesat e paraqitura dhe marrjen në provim të kandidatëve për agjent doganor. Sektori i Procedurave Doganore në bashkepunim me komisionin, grumbullon dhe administron materialet përkatëse të testimit.

5. Provimi në të cilin duhet te marrë pjesë dhe të kalojë çdo person që kërkon të licensohet si “agjent doganor” konsiston në një kontroll me shkrim dhe në menyrë elektronike;

- mbi legjislacionin doganor në fuqi, ligjin për akcizën, dhe ligjin për TVSH-në, si dhe lidhur me zbatimin praktik të tyre.
- plotësimi i DAV në të gjitha fushat e deklaratës doganore përfshirë dhe llogaritjen e detyrimeve, klasifikimin e mallrave, etj.

6. Fitues do të jenë të gjithë kandidatët që kanë grumbulluar më shumë se 70 pikë në testim.

7. Komisioni brenda 30 ditëve nga data e provimit mban një proçes-verbal lidhur me pjesëmarrjen, ecurinë e proçesit, si dhe pikët e grumbulluara nga çdo pjesëmarrës. Lista me rezultatet e pjesëmarësve shpallet në ambientet e DPD-së.

8. Në përfundim të gjitha materialet e testimit dërgohen në arxivën e DPD.

## VIII. Personeli Ndihmës

1. Kundrejt një kërkesë me shkrim nga agjencia doganore e interesuar, DPD autorizon një person apo individ të caktuar për të punuar si punonjës ndihmës pranë agjencisë doganore në fjalë.

2. Individ i në këtë rast duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- të ketë shtetësi shqiptare;
- të jetë mbi moshën 21 vjeç;
- të gjykohet i besueshëm nga administrata doganore.

3. Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqitet është si më poshtë:

- kërkesë me shkrim nga agjencia doganore pranë së cilës do të punojë personi;

- kopje e kartës së identitetit/pasaportës (për të provuar që është person i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë me përjashtim të rasteve që parashikohen në nenin 155 pika 3 të Ligjit 102/2014 - Kodi Doganor);
  - vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Organi i Prokurorisë, si dhe vërtetimi i gjëndjes gjyqësore (dëshmia e penalitetit) për të provuar që personi nuk është dënuar për një vepër penale dhe nuk ka asnjë proces penal të hapur pér të në gjykatë;
4. Për efekt të regjistrimit të personelit ndihmës në regjistrin elektronik të përfaqësuesve doganorë edhe punonjësit ndihmës do të pajisen me një kod identifikimi personal, por ata nuk lejohet të nënshkruajnë apo vulosin asnjë deklaratë doganore. Punonjësve ndihmës nuk ju hapen user përdorimi në sistem.

## **IX. Transferimi**

1. Transferimi i agjentëve doganorë të licencuar nga një agjenci doganore në një tjetër bëhet vetëm me miratim të DPD.
2. Dokumentacioni që duhet paraqitur në DPD pér transferimin e agjentëve doganorë është si më poshtë:
  - a) kërkesë me shkrim nga agjencia doganore pér të cilën kërkohet të veprojë agjenti doganor;
  - b) kopje e licencës individuale të agjentit (leshuar nga DPD në momentin e licencimit);
  - c) kopje e licencës së angjesisë doganore(leshuar nga DPD në momentin e licencimit);
3. Pas plotësimit të dokumentacionit të mësipërm, DPD miraton transferimin dhe kryen ndryshimet përkatese në sistem, si dhe në regjistrin e agjentëve.

## **X. Karta e identifikimit**

1. Agjentët doganorë dhe personeli i tyre ndihmës duhet të pajisen me kartë identifikimi, e cila duhet të mbahet në një vend të dukshëm gjatë kohës së ushtrimit të aktivitetit të tyre, si përfaqësues.
2. Karta e identifikimit duhet të përbajë të dhënat si vijon:
  - a) fotografinë, emrin dhe mbiemrin e agjentit doganor/personelit ndihmës;
  - b) emrin e agjencisë doganore që përfaqëson,
  - c) numrin e kodit individual të identifikimit.

Karta e identifikimit vuloset nga DPD. Një model i kartës së identifikimit paraqitet në *Aneksin 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi*.

## **XI. Regjistrimi i operacioneve dhe ruajtja e dokumentacionit**

1. Agjentët doganor duhet të regjistrojnë të gjitha operacionet që kryejnë në një regjistër, i cili mund të jetë edhe në formën e një regjistri elektronik. Formati i regjistrat paraqitet në *Aneksin 6, bashkëngjitur*.
2. Agjentët doganor duhet të mbajnë dhe të ruajnë dokumentacionin mbi bazën e të cilit është kryer deklarimi,në përpunhje me udhëzimin nr.13 datë 28.09.2018 “Mbi ruajtjen e dokumentave dhe informacioneve të tjera”.
3. Agjentët doganorë duhet të ruajnë autorizimet/prokurën e përfaqësimit, registrat dhe dokumentet

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Rruga e Durrësit, 127, Laprakë, Tiranë; Tel: +355 422 53 820

që dëshmojnë se kanë paguar të gjitha detyrimet për të paktën 5 (pesë) vjet, në përputhje me nenin 52, të Kodit Doganor dhe legjislacionin tatimor.

## XII. Dispozita të fundit

1. Procedurat për pezullimin, shfuqizimin dhe ankimin janë të përcaktuara në nenin 87 të Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor.
2. Agjentët doganorë janë përgjegjës për çdo shkelje të kryer siç parashikohet në titullin IX, të Kodit.
3. Nëse agjenti doganor nuk ka punuar për një periudhë kohe (është jo-aktiv në sistemin Asycuda WORLD), ri-aktivizimi i tij do të kryhet pas verifikimit të kushteve të besueshmërisë.
4. Çdo përfaqësues doganor ka të hapur në sistemin Asycuda WORLD vetëm një user, i cili duhet të përdoret vetëm prej tij. Në rast të konstatimit të përdorimit të userit të përfaqësuesit do të merren masa deri në shfuqizimin e licencës.
5. Përfaqësuesit doganor janë përgjegjës për përbushjen e të gjitha detyrimeve sipas përcaktiveve të Kodit Doganor në veçanti nenet 23, 72, 73, 76, 155, 170, si dhe neneve 86, 87, 689, etj., të Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor.
6. Të gjitha agjencitë doganore (Person Juridik) janë të detyruara që në fillim të çdo viti të informojnë DPD mbi agjentët doganorë aktiv që punojnë për llogari të tyre, si dhe të shprehen për secilin prej tyre nëse vazhdojnë ti plotësojnë kushtet e përcaktuara për ushtrimin e veprimtarisë së “agjentit doganor” për të cilin janë licencuar.
7. Ky Udhëzim shfuqizon udhëzimin Nr. 9, datë 09.12.1999 “Mbi disa probleme që lidhen me përfaqësimin në doganë”, udhëzimin Nr. 03, datë 11.11.2009 “Mbi zbatimin praktik të procedurave të miratimit dhe funksionimit të përfaqësimit të drejtpërdrejtë në doganë”, si dhe akte të tjera që kanë lidhje me përfaqësimin, të dala në zbatim të ligjit Nr. 8449, datë 27.01.1999 dhe VKM Nr. 205, datë 13.04.1999.
8. Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen Web të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.



Anekxi 1

“Aplikimi për miratimin e përfaqësimit të drejtpërdrejtë në doganë”

Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave  
Drejtorisë së Procedurave Doganore

I. Format që plotësohet nga aplikuesi

1. Aplikuesi/kerkuesi (emër, adresa, e-mail)	Rezervuar për qëllime doganore
2. Statusi Ligjor i aplikuesit	3. Data e themelimit
4. Administratori/Përfaqësuesi Ligjor/Ortaket (aktionieret) – “I përfaqësuari” Në cilesinë e personit që kërkon të përfaqësitet në dogane për veprimet që lidhen me plotesimin e formalitetave të deklarimit doganor.	
5. Numër Identifikimi i aplikuesit (NIPT/NUIS)	
6. Personi i kontaktit (emri, telefoni, fax, email)	7. Vendi ku mbahen illogaritë kryesore të biznesit
8. Objekti i aktivitetit të aplikantit:	
9. Z. /Znj. _____, me numer ID _____, i caktuar për kryerjen e përfaqësimit të drejtpërdrejtë ne dogane (perfaqësuesidoganor):	
10. Deklarim të mallrave për: <input type="checkbox"/> Transit <input type="checkbox"/> Eksport <input type="checkbox"/> Regjime të tjera doganore <input type="checkbox"/> Deklarim i Thjeshtuar <input type="checkbox"/> Magazinim i Përkohshëm <input type="checkbox"/> Deklaratë përbledhëse e hyrjes/e daljes <input type="checkbox"/> Deklaratë Rieksporti / Njoftim riekporti	
11. Zyra/Zyrat doganore të kërkuara:	
12'. Emër mbiemër, nënshkrimi i kërkuesit :	
13. Vendi, Data:	

## **II. Shqyrtimi nga DPD i plotësimit të kritereve dhe dokumentacionit.**


**Dokumentacioni bashkengjitur:**

- Dokument identifikimi : Pasaportë  Kartë Identiteti
- Kontratë pune
- Kopje e Diplomës Universitare
- Prokurë e posacme përfaqesimi
- Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor
- Vërtetim nga Prokuroria
- Vërtetim të Gjëndjes Gjyqësore (Deshmi Penaliteti)
- Vërtetim/konfirmim nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve për kontributet

Emër Mbiemër (Punonjësi i D.P.Doganave): ..... Nënshkrimi:

Datë:.....

- 
1. Personi i përcaktuar si përfaqesues(me dokumentin e tij të identifikimit) duhet të nënshkruaje në prezencë të punonjësit doganor që shqyrton aplikimin, duke bërë të mundur depozitimin e firmës.



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

AUTORIZIM Nr. ....D

Në mbështetje të meneve 24 - 26 të Ligji nr. 102/2014 datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", si dhe nenet 78 pika 7 e 8, si dhe nenet 79 - 81 të VKM Nr. 651, datë 10.11.2017; autorizohet Z. .... të kryejë përfaqësimin e drejtpermëdhetës së shqipërisë "....." me NIP/NUIS: ..... dhe kod: D .....

TIRANË, me \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_  
Nr. ....Prot. Datë .....

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Shënim: Ky autorizim është i vlefshëm në rastet e deklarimit të mallrave për transit, vendosje në qarkullim të lirë apo regjime ekonomike, eksport, etj

Anekksi 3 "Modeli i Licencës së agjentit doганor"



R E P U B L I K A E S H Q I P È R I S È

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

LIÇENCË Nr.

Në mbëshqetje të neneve 24 - 26 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", si dhe neneve 78 - 88 të VKM Nr. 651, datë 10.11.2017, "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor", Z/Zni....., i miratohet leja e ushurimit të aktivitetit si "Agjent Doganor".

TIRANË, me \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ Prot.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aneksti 4 "Modeli i Licencës së agjencisë doganore"



R E P U B L I K A E S H Q I P È R I S È

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

LICENCË Nr. J...

Në mbështetje të neneve 24 - 26 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", si dhe neneve 78 - 88 të VKM-së Nr. 651, datë 10.11.2017 "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor", Personit Juridik "....." me NIPT/NUIS : ....., i miratohet e drejta të veprojë si "Agjenci Doganore" në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

TIRANË, me \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_ / \_\_\_\_ Prot.

DREJTOR I PËRGJITHSHUËM

Aneksi 5 "Karta e identifikimit të agjentëve doganorë dhe personelit të tyre ndihmës"

KARTË IDENTIFIKIMI	
Foto	Emri Mbiemri Agjencia doganore Kodi individual i identifikimit

Aneksi 6 "Modeli i Regjistrit të agjencisë doganore"